

## **KOALICIONI PËR KOMRA**

### **DRAFT STATUTI I KOMISIONIT RAJONAL PËR VËRTETIMIN E FAKTEVE MBI KRIMET E LUFTES DHE SHKELJET TJERA TË RËNDA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË HAPËSIRAT E ISH JUGOSLLAVISË**

**- 2. shtator 2010. –**

## Neni 5.

### Periudha e veprimit

1. Mandati i zgjatjes së KOMRA-s përfshin periudhën dyvjeçare, pas periudhës gjashtëmuajore të përgatitjes.
2. KOMRA mund të zgjat mandatin më së shumti gjashte muaj.

*Më shqetëson paksa mandati i komisionit, vetëm dy vite. Mendoj se është e pamundur të zgjidhet kjo çështje për dy vite. Unë kam menduar se do të jetë i vazhdueshëm dhe se kjo do të jetë mandat i anëtarësisë. Jam i sigurt se për dy vite, nuk do të mund të zgjidhet ky problem. (Dušan Cvjetković, Forumi demokratik Serb, Knin, Kroaci, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi draftin e Statutit të KOMRA-së, Knin, Kroaci, 2. shtator 2010.)*

*Sa i përket kohëzgjatjes së komisionit, gjithashtu edhe mua po me duket se dy vite është kohë e shkurtë, por unë jam për një afat kohor të tillë të shkurtë, me së shumti tri vite. (Boris Milošević, Këshilli kombëtarë serb, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi draftin e Statutit të KOMRA-së, Knin, Kroaci, 2. shtator 2010.)*

## Neni 27.

### Mbajtja e dëgjimeve publike të viktimave dhe personave tjerë

1. KOMRA organizon dëgjime publike përmes të cilave viktimat mund ta njoftojnë publikun më të gjerë për vuajtjet e tyre dhe të afërmit e tyre. Dëgjimet publike të dëshmitarëve bëhen në baza vullnetare.

*(...) nëse i vejmë gjërat në atë mënyrë, ashtu që personat të kenë mundësi të refuzojnë të dëshmojnë, e të themi se është i vetmi i mbijetuari i ndonjë krimi masiv, do të kemi vështirësi të mëdha të vërtetojmë faktet e vërteta. Mendoj se këtu do të duhej më shumë të shkojmë drejt krijimit të një mbështetje më të fortë kualitative për viktimat të cilat do të dëshmojnë, por megjithatë në ndonjë mënyrë të vendosën gjërat në atë mënyrë që, nëse ftohen ata duhet të dëshmojnë. (Slaven Rašković, Documenta, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi draftin e Statutit të KOMRA-së, Knin, Kroaci, 2. shtator 2010.)*

*(...) nëse dëshmia e dëshmitarit do të ishte e obligueshme, atëherë kjo do të thoshte se është i paraparë edhe sanksioni për te, nëse ai person refuzon të japë dëshminë. Dhe mendoj, se kur dikush do ta merrte ftesën nga KOMRA për të dëshmuar nën kërcënimin e sanksioneve, atëherë ajo dëshmi do të ishte e dhënë nën frikë. Pra, ndoshta unë do të jem i akuzuar, i dënuar, i dyshuar, i shpallur tradhtarë dhe i etiketuar në të gjitha mënyrat tjera. (Boris Milošević, Këshilli kombëtarë serb, Zagreb, Kroaci, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi draftin e Statutit të KOMRA-së, Knin,*

Kroaci, 2. shtator 2010.)

*Fatkeqësisht, sot në për çdo informatë duhet të paguajmë. Nëse ndokush është i gatshëm të japë dëshminë e tij, pse mos ta caktojmë shpërblimin, në mënyrë që dikush i cili është dukë e kërkuar fëmijën e vet që 15, 20 vite, prandaj mendoj se do të mund të themelohet ai fond që do të mund të jepte informacionin relevant. (Zdenka Šimpraga, Dua të shkoj në shtëpi, Knin, Kroaci, Konsultimet lokale me shoqërinë civile mbi draftin e Statutit të KOMRA-së, Knin, Kroaci, 2. shtator 2010.)*

2. Në kuadër të dëgjimeve publike mund të dëgjohen edhe dëshmitarët e krimeve të luftës, respektivisht dëshmitarët e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, kryesit e krimeve të luftës apo shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe personat që u kanë ndihmuar viktimave apo që me veprimet e veta u kanë mundësuar njerëzve që të mos jenë viktima të krimeve të luftës, respektivisht viktima të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut.
3. Gjatë dëgjimeve publike KOMRA mund të marrë masa për mbrojtjen e identitetit, sikurse edhe masa të posaçme për mbrojtjen e integritetit psikik dhe fizik të personit që dëshmon.
4. Mediat elektronike në pronësi të shtetit, respektivisht mediumet publike në hapësirat e ish RSFJ-së, kanë për detyrë t'i emitojnë dëshmitë publike. Mediat elektronike komerciale kanë të drejtë t'i emitojnë dëshmitë publike, me të njëjtat kushte dhe rregulla që vlejnë edhe për mediat në pronësi shtetërore, respektivisht mediumet publike.
5. Dëgjimet publike mund të mbahen në vende të ndryshme.